

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit D. X., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson L. B., nga S.e P. P.T.K., kundër të paditurës PTK sh.a. në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F. R., jurist pranë të paditurës, për kompensim të diferencës së pagës, lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2262/2013, datë 18.12.2015, në seancën e mbajtur më 17.5.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2262/2013, datë 18.12.2015, përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të të paditurës nr.... datë ..., me të cilin paditësit i është ulur niveli i gradës së punës nga 14 në 13.

Pranohet revizioni i të paditurës në pjesën I të dispozitivit që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësit t'ia paguajë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit midis gradës 14 dhe 13, për çdo muaj, duke filluar nga data 1.2.2012 deri më 16.6.2012, me kamatëvonesë vjetore prej 3.5%, duke filluar nga data 1.2.2012 deri te pagesa definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim dhe lidhur me këtë pjesë prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2262/2013 datë 18.12.2015 dhe ai i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr.1152/2012 datë 16.1.2013, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr.1152/2012 datë 16.1.2013, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, është anuluar aktvendimi i të paditurës nr. ... datë ..., dhe është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit midis gradës 14 dhe 13 për çdo muaj, duke filluar nga data 1.2.2012 deri më 15.6.2012, me kamatëvonesë vjetore prej 3.5%, duke filluar nga data 1.2.2012 deri te pagesa definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2262/2013 datë 18.12.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë, përveç sa i përket kamatës së aprovuar, në të cilën pjesë aktgjykimi është ndryshuar, ashtu që është detyruar e paditura që paditësit, mbi shumat e caktuara t'ia

paguajë kamatën që e paguajnë bankat afariste për mjetet e depozituara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1.2.2012, gjer te pagesa definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të pranohet revizioni dhe të prishen të dy aktgjykimet e mësipërme, kurse lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion në bazë të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe konstatoi:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, sipas kontratës së punës të lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, si punëdhënëse, paditësi ka themeluar për kohë të caktuar marrëdhënie pune në vendin e punës menaxher i sigurisë dhe mbrojtjes në punë, mbrojtjes nga zjarr dhe për emergjencë, duke iu caktuar paga bazë për punën të cilën e kryen në nivel të gradës 14. Mirëpo, me aktvendimin e të paditurës nr.... datë ..., paditësit i caktohen të ardhurat personale në nivel të gradës 13 prej datës 1.2.2012 e tutje, duke e konsideruar këtë aktvendim si pjesë përbërëse të kontratës së punës, me këshillën juridike se ky aktvendim mund të ankimohet në Komisionin e ankesave në afat prej 8 ditësh. Paditësi është ankuar kundër këtij aktvendimi, por nuk ka marrë përgjigje prej të paditurës. Ulja e gradës së pagesës për paditësin na grada 14 në gradën 13, sipas të paditurës, është bërë në bazë të shkresës së ministrit Besim Beqaj të datës 6.10.2011, drejtuar kryetarit të Bordit të Drejtorëve të të paditurës, me qëllim ngritjen e vlerës së përgjithshme të PTK-ës, në të cilën shkresë është kërkuar që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve operative vjetore duhet të reduktohet për vitin 2012 në jo më shumë se 20%.

Mbi këtë gjendje faktike kështu të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, prandaj anuloi vendimin kontestues të së paditurës për uljen e pagës së paditësit nga grada 14 në 13 dhe e detyroi të paditurën që t'ia paguajë atij diferencën e pagës sipas gradës 14, pasi që konstatoi se e paditura, duke ia ulur paditësit gradën prej 14 në gradën 13 në mënyrën e përshkruar më lart, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 par.1 pika 1.8 e nenit 55 par.2 të Ligjit të Punës dhe nenit 5 të kontratës së punës. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se marrëdhënia e punës e lidhur në kontratën e përshkruar më lart mes paditësit dhe të paditurës është marrëdhënie e kontraktuar e krijuar në bazë të kushteve për lidhjen e saj, duke përfshirë aftësitë e palëve kontraktuese, vullnetin e tyre, lëndën dhe bazën e kontratës. Palët, sipas parimit të së drejtës, me vullnetin e tyre të lirë kanë krijuar raporte reciproke juridike, të cilat mund t'i ndryshojnë gjithashtu vetëm me vullnetin reciprok të tyre. Prandaj rezulton se kontrata e punës dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga e paditura. duke cenuar të drejtat kontraktuese të paditësit. Aktvendimi i goditur i të paditurës është i kundërligjshëm dhe, si i tillë, nuk mund të trajtohet si pjesë e kontratës, përderisa për ndryshimin e kontratës dhe kushteve të saj me këtë aktvendim nuk ka dhënë pëlqimin edhe pala tjetër kontraktuese, këtu paditësi.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të saj.

Nisur nga kjo gjendje faktike, Gjykata Supreme e Kosovës e pranoi si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të të dyja shkallëve, lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me anulimin e vendimit të së paditurës për uljen e gradës së punës për paditësin prej 14 në 13, pasi që aktgjykimet e tyre nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër, gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e mësipërme në këtë pjesë nuk përfshihen as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat gjykata e revizionit i vëren sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi gjykata e revizionit i pati pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale parashikuar nga neni 182.2 pika (n) të LPK. Gjykata e revizionit vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv, as në arsyetimin e tyre, por përkundrazi, ato janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, ndërkaq në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë plotësisht të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit, prandaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara.

U refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet e tjera të revizionit për shkelje thelbësore procedurale të parashikuara nga neni 182.1, lidhur me nenet 190 e 191 të LPK, të cilat, sipas të paditurës, qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së dytë, me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës, nuk ka mbajtur seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes, në të cilën do të duhej të thirreshin edhe palët. Këto pretendime të revizionit janë të pabazuara, për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë mbështetur mbi gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, kështu që, duke vlerësuar edhe se në procedurë ankimore nuk janë paraqitur fakte dhe prova të reja, gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur për obligim të mbajë seancë gjyqësore në prezencën e palëve me rastin e ankesës së të paditurës.

Qëndron fakti se në raste të tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë, në kolegje të ndryshme, ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë, në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit, në mënyrë që, me vendim gjyqësor të kësaj Gjykate, të eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin edhe pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, parashikuar nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Sipas të paditurës, padia e paditësit, lidhur me pjesën ku është kërkuar anulimin e vendimit për uljen e gradës, është e vonuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitje të padisë, ngase kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës, për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të së paditurës për uljen e pagës. Për kërkesa të tilla, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, afati i parashkrimit është 3 vjet dhe jo që, siç pretendohet

në revizion, afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i punësuarit ka të drejtën e pagës e cila i caktohet atij me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe me aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit, sipas kontratës së punës, ishte caktuar sipas gradës 14, prandaj ulja e saj nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës. Kërkesa e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomike, lidhur me shpenzimet e uljeve operative tek e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se për cilat shpenzime operative bëhet fjalë dhe as që rekomandohet ulja e pagave, kështu që e paditura është dashur të paraqesë një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve, duke i precizuar ato, por një provë e tillë nuk është paraqitur prej saj. Prandaj, thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Nuk ka prova që e paditura të ketë bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me uljen e gradave, gjë që nuk mund të bëhet me një vendim të njëanshëm të kryeshefit ekzekutiv të së paditurës.

Mirëpo, aktgjykimet e lartpërmendura, në pjesën e tyre gjykuese me të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë ndryshimin e pagës, bonusit të trustit ndërmjet gradës 13 dhe 14, përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 182.2 pika (n) të LPK, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë, si i tillë, është i paqartë në dispozitiv dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, meqë në dispozitiv nuk është përcaktuar niveli i këtij ndryshimi të pagës dhe të bonusit të trustit mes këtyre gradave që duhet paguar e paditura. Një aktgjykim i tillë nuk mund të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme. Edhe kërkesëpadia në këtë drejtim ka qenë e parregullt. Për pasojë të këtyre shkeljeve thelbësore procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Në rigjykim, për sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë, duhet të ftohet pala paditëse për ta bërë saktësimin (precizimin) e kërkesëpadisë dhe, në lidhje me këtë, pastaj gjykata e shkallës së parë të nxjerrë prova për të vërtetuar konkretisht se cila është shuma e ndryshimit të pagës dhe bonusit të trustit mes këtyre gradave, kështu që, pas administrimit të provave të tjera të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të drejtë të tyre, për këtë çështje të vendosë në mënyrë meritore.

Për arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 lidhur me nenin 224.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.131/2016 datë 17.5.2016

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku